

VENDIM
Nr. 55, datë 1.10.2014

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË BANKAVE DHE DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 52/2014, datë 22.5.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009 të Këshillit Mbikëqyrës, dhe ndryshuar me vendimin nr. 33, datë 11.5.2011 dhe vendimin nr. 28, datë 16.5.2012 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, si më poshtë vijon:

a) Paragrafi i fundit i nenit 2 ndryshon me përmbajtje, si më poshtë: “Ligjit nr. 52/2014, datë 22.5.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit””.

b) Në nenin 13, shkronja “b” togfjalëshi “projektin e ndryshuar të statutit” zëvendësohet me togfjalëshin “statutin e ndryshuar,...”.

c) Pikat 2 dhe 3 të nenit 16 rinumërtohen përkatësisht pika 3 dhe 4.

d) Në nenin 16, pas pikës 1 shtohet pika 2, me përmbajtjen e mëposhtme:

“2. Banka e Shqipërisë, përveç sa është parashikuar në pikën 1 të këtij neni, shqyrton dhe bën një analizë të:

a) kushteve ekonomike dhe politike të vendit ku do të ushtrojë veprimtarinë dega, agjencia ose filiali;

b) tipareve të sistemit bankar dhe/ose financiar të vendit ku do të ushtrojë veprimtarinë dega, agjencia ose filiali;

c) skemës së mbikëqyrjes bankare në vendin ku do të ushtrojë veprimtarinë dega, agjencia ose filiali, si dhe aftësisë së autoritetit të mbikëqyrjes bankare në këtë vend, për përmbushjen e këtij funksioni;

d) legjislacionit dhe praktikave të kontabilitetit që zbatohen në vendin ku do të ushtrojë veprimtarinë dega, agjencia ose filiali.”.

e) Në nenin 17, pas shkronjës “g” të pikës 2, shtohet shkronja “h”, me përmbajtjen e mëposhtme:

“h) planin e biznesit sipas kërkesave të nenit 7, paragrafi 1, shkronja “e”, të kësaj rregulloreje, në rastet kur kërkohet transferimi i pjesëmarrjes influencuese që tejkalon nivelin 33 ose 50 për qind të kapitalit të bankës ose të të drejtave të votës apo në një masë të tillë që banka të bëhet filial i tij”.

f) Në nenin 18, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) në pikën 8, togfjalëshi “ligjin nr. 9267, datë 29.7.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”” zëvendësohet me togfjalëshin “ligjin nr. 52/2014, datë 22.5.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit””.

ii) në pikën 8, shkronja “c”, togfjalëshi “projektin e ndryshuar të statutit” zëvendësohet me togfjalëshin “statutin e ndryshuar,...”.

iii) në pikën 8, shkronja “d” ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“d) planin e biznesit për kryerjen e një veprimtarie të tillë;

iv) pika 9 rinumërtohet dhe bëhet pika 11;

v) pas pikës 8 shtohen pikat 9 dhe 10 me përmbajtjen e mëposhtme:

“9. Banka mund të investojë mbi 15 për qind të kapitalit të saj rregullator në kapitalin e një personi juridik që nuk ushtron veprimtari bankare, vetëm me miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë. Në këtë rast, banka paraqet në Bankën e Shqipërisë kërkesën përkatëse të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimin e asamblesë së aksionarëve të bankës për investim në kapitalin e institucionit financiar;

b) relacionin shoqërues me përmbajtjen e investimit që synohet, si edhe strategjinë e bankës;

c) mënyrën e realizimit, masën e tij, si dhe arsyet e kësaj pjesëmarrjeje;

d) marrëveshjen e lidhur midis bankës dhe institucionit financiar për pjesëmarrjen në kapital;

e) parashikimin mbi treguesit mbikëqyrës si rrjedhojë e investimit (mjaftueshmëria e kapitalit, kapitali rregullator, ekspozimi), si dhe efektet financiare.

10. Banka e Shqipërisë ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për miratim në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për miratim nuk plotësohet nga subjekti brenda 6 (gjashtë) muajve pas datës së aplikimit fillestar për marrjen e miratimit. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të kërkesës për miratim, Banka e Shqipërisë njofton me shkrim subjektin. Subjekti ka të drejtë të kërkojë rifillimin e procedurës së miratimit paraprak duke paraqitur dokumentacionin e ri.”.

g) Në nenin 19 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) pika 3, pas togfjalëshit “të aktivitetit të degëve ose agjencive të saj” shtohet togfjalëshi “si dhe paraqet në Bankën e Shqipërisë dokumentacionin e përcaktuar në pikën 5, të nenit 14 të kësaj rregulloreje.”;

ii) pas pikës 4 shtohet pika 5 me përmbajtjen e mëposhtme:

“5. Banka e Shqipërisë mund të refuzojë ofrimin e shërbimeve bankare dhe/ose financiare ndërkufitare jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të njoftuara nga banka, në rastet kur vlerëson se:

a) nuk janë krijuar sistemet e përshtatshme për administrimin në vazhdimësi të rrezikut që rrjedh nga këto shërbime, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në faktorë të tillë si:

i) rreziku i vendit ku do të ofrohet ky lloj shërbimi;

ii) rreziku i përputhshmërisë (rreziku ligjor);

iii) kuadri ligjor dhe rregullativ i vendit ku do të ofrohet ky lloj shërbimi;

iv) standardet e kontabilitetit në vendin ku do të ofrohet ky lloj shërbimi;

v) përfitueshmëria dhe sfidat në ofrimin e këtij lloj shërbimi.

b) nuk janë zbatuar kërkesat për publikimin e informacionit të nevojshëm për këtë lloj shërbimi për klientët, sipas kategorive të mëposhtme:

i) emri i bankës dhe vendndodhja e zyrës qendrore të saj (ose zyrave lokale nëse është e aplikueshme);

ii) autoriteti mbikëqyrës i vendit të origjinës;

iii) mjetet e kontaktit të klientëve me qendrën e shërbimit të klientëve lidhur me problemet mbi shërbimin ndaj klientelës për ankesat, etj.;

iv) mundësia e aksesit në skemat e zgjidhjes së ankesave të klientëve në rrugë jashtëgjyqësore;

v) çdo lloj informacioni që mund të nevojitet ose kërkohet sipas juridiksionit të vendit ku do të ofrohet ky lloj shërbimi; si dhe

c) në çdo rast:

i) kapitali bazë i bankës, si rezultat i ofrimit të këtij shërbimi bie nën nivelin e shumës së kapitalit fillestar minimal të kërkuar nga Banka e Shqipërisë;

ii) gjendja financiare e bankës, që ushtron veprimtari bankare dhe financiare në Shqipëri, është vlerësuar nën nivelin mesatar sipas klasifikimit “CAMELS” ose “CAELS” më të fundit;

iii) raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës, me ofrimin e këtij shërbimi bie nën nivelin minimal të kërkuar;

iv) ofrimi i këtij shërbimi vë në rrezik pozitën financiare, mbikëqyrëse apo vazhdimësinë operacionale të bankës, mbështetur në para-shikimet për tre vitet e para për këtë lloj shërbimi.”.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Elisabeta Gjoni

